



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:210754

Datë: 29.10.2024

Numri i dokumentit: 06364397

PAKR.nr.436/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti i Krimeve të Rënda, në Kolegjin Penal të përbërë nga gjyqtarët, Ferit Osmani kryetar, Burim Ademi dhe Mentor Bajraktari anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Gazmend Ramadani, në çështjen penale ndaj të akuzuarit N.S, për shkak të veprës penale Falsifikim i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar nga ana e mbrojtëses së të akuzuarit N.S, av. Jovana Filipoviq, ankesë kjo e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.75/2024 të datës 30.05.2024, në seancën e kolegjit me datë 20.09.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET ankesa e mbrojtëses së të pandehurit N.S, dhe NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.75/2024 të datës 30.05.2024, lidhur me dënimin me gjobë ashtu që të akuzuarit N.S për shkak të veprës penale Falsifikim i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së, për të cilën është shpallur fajtor, ashtu që kjo gjykatë i shqipton dënim me gjobë në shumën prej 2000 (dymijë euro)Euro të cilin dënim është obliguar ta përmbushë me (4) katër këste, duke paguar me datën 5 të muajit vijues, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
- II. Pjesa tjetër e aktgjykimit të ankimuar, mbetet e pandryshuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda me aktgjykimit PKR.nr.75/2024 të datës 30.05.2024, ka shpallur fajtor të akuzuarin, N.S për shkak të veprës penale Falsifikim i parasë nga neni 296 par.2 të KPRK-së. Të akuzuarin gjykata e shkallës së parë e ka dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, dënim i cili me pëlqimin e të pandehurit iu është zëvendësuar me dënimi me gjobë në shumën prej 3000(tremijë) Euro, të cilin dënim është obliguar ta përmbushë me dy këste, duke paguar me datën 5 të muajit vijues, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, atëherë i njëjti do ti zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 euro (njëzet euro) të papaguara do ti llogariten 1 (një) ditë burg. Konform nenit 296 par.6 të KPRK-së, është konfiskuar monedha e falsifikuar 500 (pesëqind) Euro me nr. Serik P26054369263. Është obliguar ti paguaj shpenzimet e procedurës sipas llogaritjes së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) Euro, brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi ka parashtruar ankesë:

Mbrojtësja e të akuzuarit Nikolla Stojanoviq avokatja Jovana Filipoviq për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe ta ndryshojnë aktgjykimin e ankimuar, ashtu që të akuzuarve ti shqiptohet dënim më i butë.

Prokuroria e Apelit, ka paraqitur parashtresën me shkrim PPA/I.nr.397/2024 të datës 23.07.2024, me propozim që të refuzohet si e bazuar ankesa e mbrojtëses së të pandehurit, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet

Gjykata e Apelit fillimisht ka vlerësuar ankesën nëse është e lejueshme dhe e afatëshme. Kolegji ka gjetur se ankesa është e lejueshme, duke qenë se është parashtruar nga ana mbrojtjes. Po ashtu ankesa rezulton se është e afatëshme, pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se aktgjykimit i ankimuar nga i pandehuri është pranuar me datë 18.06.2024, ndërsa mbrojtësja e të pandehurit e ka pranuar me datë 14.06.2024, kurse ankesa është ushtruar me datë 05.07.2024. Nga këto rrethana rezulton se ankesa është brenda afatit që parasheh neni 380 i Kodit të Procedurës Penale

Gjykata ka caktuar seancën e kolegjit në të cilën ka njoftuar palët për vendin, dhe kohën e mbajtjes së seancës. Në këtë seancë nuk ka prezantuar prokurori i Prokurorisë së Apelit, i janë dërguar dhe pranuar në mënyrë të rregullt. Ndërsa, kane prezantuar i akuzuari N.S dhe mbrojtësja e të pandehurit av.Jovana Filipoviq

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të mbrojtëses të të akzuarit, propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Pretendimet ankimore.

Në ankesë mbrojtësja e të pandehurit N.S av. Jovana Filipoviq pretendon se i pandehuri ka pranuar kryerjen e veprës me të cilën ngarkohet dhe nuk kishte rrethana rënduese kundër tij, duke konsideruar se kanë ekzistuar rrethana lehtësuese në favor të të pandehurit të cilat gjykata është dashur t'i vlerësoj, prandaj i propozojmë Gjykatës së Apelit që gjobën e shqiptuar t'ia zvogëloj. Tutje thekson se i akuzuari është person i ri, student, i cili edhe me gjithë shkollimit duhet t'i sigurojë mjetet financiare në atë mënyrë që kryen shërbimin e fotografimit në dasma, tutje pretendon se kurrë më parë nuk ka qenë i dënuar e as që ka pasur kallëzime penale dhe është i gjendjes së varfër ekonomike. Andaj konsideron që gjoba e shqiptuar në lartësi prej 3000 (tre mijë) euro është tejet e ashpër dhe e lartë dhe se gjykata duhej t'i vlerësoj rrethanat e rastit konkret e sidomos sjelljen e kryesit pas kryerjes së veprës, dhe propozona që Gjykata e Apelit të Kosovës ta ndryshon aktgjykimin e ankimuar sa i përket pjesës i cili ka të bëjë me lartësinë e gjobës, dhe që akzuarit ti shqiptoj dënim/gjobë më butë, dhe t'i lejoj të pandehurit që gjobën ta paguaj në më shumë këste mujore.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit ka parasysh se ankesa e mbrojtësit të pandehurit nuk është parashtruar për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, andaj në këtë rast kjo gjykatë ka vlerësuar aktgjykimin për sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale duke qenë se dispozita nga neni 394 paragrafi 1, ka paraparë se gjykata e Apelit sipas detyrës zyrtare duhet të

shqyrtoj aktgjykimin nëse është marr me shkelje esenciale që janë të parapara në nenin 384 paragrafi 1. Duke vlerësuar aktgjykimin dhe shkresat tjera të lëndës kolegji ka konstatuar se aktgjykimi nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale të cilat do ta bënin juridikisht të paqëndrueshëm aktgjykimin.

Po ashtu, kolegji ka parasysh se aktgjykimi nuk është ankimuar për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, e siç rrjedhë në rastin konkret nga aktgjykimi, i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale që ngarkohej me akuzë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit vëren se aktgjykimi nuk është ankimuar për bazën ligjore të shkeljes së ligjit penal, e duke marrë për bazë dispozitën nga neni 394 paragrafi 1, e cila përcakton se Gjykata e Apelit me rastin e shqyrtimit të ankesës gjithnjë shqyrton sipas detyrës zyrtare nëse është shkelur ligji penal, në këto rrethana gjykata ka vlerësuar se ligji penal është zbatuar drejtë dhe është zbatuar ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale. Rrjedhimisht rezulton se është zbatuar ligji penal që është dashur të zbatohet. Andaj në këto rrethana nuk rezulton se është shkelur ligji penal.

Për sa i përket pretendimeve ankimore të mbrojtjes lidhur me vendimin mbi sanksionin penal, se në rastin konkret nuk ka pasur rrethana posaçërisht renduese, por ekzistojnë rrethanat lehtësuese në favor të pandehurit ngase është i moshës së re, student, i gjendjes së varfër ekonomike si dhe asnjëherë nuk ka qenë i dënuar për vepër penale, ky kolegji konsideron se me rastin e marrjes së vendimit mbi ndryshimin e dënimit sa i përket saksionit penale do të arrihet qëllimi i dënimit, edhe me këtë dënim të shqiptuar si në dispozitov të aktgjykimit, andaj e ka gjetur si të bazuar ankesën e mbrojtëses dhe ka ndryshuar vendimin për sa i përket vetëm dënimit me burgim.

Kolegji i gjykatës së Apelit vëren se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese në raport me të pandehurin, ashtu që si rrethana lehtësuese ka gjetur: faktin se ka shprehur keqardhje për veprën e kryer, premtimin se nuk do të përsërisë veprën penale, moshën e re në kohën e kryerjes së veprës penale. Kurse, si rrethanë rënduese posaçërisht rënduese nuk gjeti, rrethanat nën të cilat janë kryer veprat penale, dhe në bazë të këtyre rrethanave ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit është zëvendësuar me dënim më gjorbë në shumën prej 3000, për veprën penale që legjislacioni parashikon dënim me burgim një (1) deri në dhjetë (10) vite, mirëpo po kolegji ka vlerësuar së në rastin konkret për shkak të rrethanave lehtësues si kërkim falje, keqardhja, pendesa, për

kryerjen e veprës penale, gjendja ekonomike kanë ndikuar që kjo gjykatë të aprovoj si të pabazuar ankesën e mbrojtëses dhe të akuzuarit ti zbutet dënimi në shumën prej 2000 euro, dhe të njëjtin dënim ta paguaj me katër këste.

Kolegji po ashtu ka parasysh se gjykata ka shqiptuar dënim nën minimumin e paraparë ligjor, që gjykatës i është dhënë diskrecioni për ti aplikuar dispozitat për zbutjen e dënimit nën minimumin e paraparë ligjor. Vepra penale që i pandehuri është shpallur fajtor për rastin konkret nga neni 296 paragrafi 2 përcakton dënimin me burgim nga 1 deri në 10 vite. Në rastin konkret rezulton se gjykata i ka shqiptuar dënim nën minimumin e paraparë ligjor, duke qenë se i ka shqiptuar dënim me burgim të kushtëzuar në kohëzgjatje prej 6 muaj, dhe se dispozita nga neni 71 dhe 72 lejojnë në rrethana të pranimit të fajësisë aplikimin e dispozitave të zbutjes së dënimit, e që zbutja rezulton se është brenda kufijve të lejueshmërisë së zbutjes.

Prandaj kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të mbrojtjes për një dënim më të ulët janë të bazuara, dhe se dënimi i shqiptuar është në përputhje me dispozitat ligjore si dhe i mbështetur në rrethanat e kësaj çështje penale, që janë vlerësuar për të përcaktuar individualizimin e dënimit, e që përfundimisht kolegji vlerëson se dënimi i shqiptuar është në funksion të qëllimit të dënimit që përcakton Kodi Penal.

Andaj për arsyet e theksuara si më lartë kjo Gjykatë bazuar në nenin 403 të KPP-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Krimeve të Rënda
PAKR.nr.436/2024 me datë 20.09.2024

B. Profesional
Gazmend Ramadani

Anëtarët e kolegjit
Burim Ademi

Kryetar i kolegjit,
Ferit Osmani

Mentor Bajraktari
